



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1662 Prot.

Tiranë, më 30 / 10 / 2019

V E N D I M

Nr. 157, Datë 30 / 10 / 2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.125, datë 02.10.2019 të znj.N. S¹, mbështetur nga organizata “Qendra për Advokim Social”, kundër shkollës 9-vjeçare “Betim Muço”, Tiranë, me pretendimin për diskriminim për shkak të “racës”². Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, znj.N. S, në ankesën e sjellë pranë KMD-së, citon se: “Në muajin Korrik 2019 është paraqitur në shkollën “Betim Muço”, e cila ndodhet në afërsi të banesës së saj, për të regjistruar fëmijën, E. S, në ciklin fillor, por nuk është pranuar nga ana e drejtorit të shkollës. Në fillim të muajit Shtator 2019, është paraqitur përsëri e shoqëruar nga aktivistët e organizatës “Qendra për Advokim Social” për të regjistruar fëmijën, por përsëri nuk është pranuar nga drejtori i shkollës. Ankuesja shpjegon se bazuar në kriteret e pranimi për regjistrimin në shkollë, fëmijës së saj i takon ligjërisht që të regjistrohet në shkollën “Betim Muço”. Znj.S informon se, si prind është në dijeni që në këtë shkollë ka fëmijë të tjerë të cilët janë me vendbanim në një zonë tjetër dhe janë regjistruar në shkollë, ndërkohë që fëmija i saj që i përket komunitetit rom nuk lejohet që të regjistrohet”.

Subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe regjistrimin e fëmijës së saj në Shkollën “Betim Muço”, Tiranë.

¹ Referuar Çertifikatës familjare, të zyrës së Gjendjes Civile të Njesisë bashkiake Nr. 6, datë 23.09.2019 znj. N. S është nëna e fëmijës E. S.

² Sipas Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës përkufizimi për “diskriminimin racial” është: “Trajtim i ndryshëm me bazë etninë, origjinën, ngjyrën, shtetësinë, besimin fetar dhe gjuhën”. Ankuesja ka provuar përkatësinë në komunitetin egjiptian, nëpërmjet Vërtetimit të datës 07/10/2019, lëshuar nga Qendra për Advokim Social.

³Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1408/2 prot., datë 04.10.2019 i është kërkuar informacion shkollës 9-vjeçare “Betim Muço” Tiranë, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
2. Në vijim të procedurës së ndjekur për shqyrtimin e ankesës, Komisioneri nxori Urdhërin nr.195, datë 17.10.2019, për kryerjen e inspektimit në shkollën 9-vjeçare “Betim Muço”, Tiranë, për marrjen e informacionit drejtëpërdrejtë, si dhe dokumentacionit shkresor përkatës.

Nëpërmjet e-mailit⁵ të datës 19.10.2019, Drejtori i shkollës 9-vjeçare “Betim Muço”, Tiranë, z.S.H, informoi Komisionerin se: *“Znj.N. S është kontaktuar nga ana e drejtorisë së shkollës dhe rezulton se ajo e ka regjistruar vajzën e saj, E. S, në një shkollë tjetër dhe nuk ka pretendime për ta sjellë vajzën në shkollën tonë dhe se nëse do e sillte ne do e regjistronim atë njëjloj si fëmijët e*

⁴Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

⁵ Emaili:@gmail.com i Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Betim Muço”, Tiranë.

tjerë”, konfirmim i cili është zyrtarizuar në vijim nëpërmjet shkresës me nr. 128 prot., datë 17.10.2019.

Me datë 24.10.2019, gjatë inspektimit në ambjentet e shkollës 9-vjeçare “Betim Muço”, Tiranë, inspektorët e KMD-së u takuan me drejtorin e kësaj shkolle, z.S.H dhe lehtësuesin/koordinatorin e organizatës “Qendra për Advokim Social”, z.F.Z. Nga ana e lehtësuesit të kësaj organizate u pohua fakti që ankuesja ka ndërruar vendbanimin, si rezultat i të cilit tani jeton në një banesë me qira pranë shkollës 9-vjeçare “Shyqyri Peza”, ku ka regjistruar fëmijën në parashkollor dhe se ajo është e kënaqur me shërbimin që i ofron kjo shkollë fëmijës së saj, prandaj nuk është më e interesuar që ta regjistrojë atë në shkollën 9-vjeçare “Betim Muço”. Pra, për sa mësipër cituar, vetë subjekti ankues me vullnetin e vet⁶, ka kërkuar ndërprerjen e procedurës hetimore nga ana e Komisionerit.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues nuk është i interesuar që ankesa e sjellë pranë KMD-së të vijojë të shqyrtohet më tej, pasi ka humbur interesin për ta regjistruar fëmijën pranë subjektit kundër të cilit kishte pretenduar diskriminimin.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), c), si dhe nenin 33, pikat 9, 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe nenin 94, pika 1⁷ e Kodit të Procedurës Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Ndërprerjen e procedurave hetimore dhe pushimin e shqyrtimit të ankesës së znj.N. S, kundër Shkollës 9-vjeçare “Betim Muço”, Tiranë, pasi ankuesja është tërhequr nga pretendimi për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Raca

⁶Referuar deklarimeve të lehtësuesit të organizatës “Qendra për Advokim Social”, në tagrin e përfaqësuesit të kësaj organizate, ankuesja ka pohuar gjithë sa më sipër citon ai, nën përgjegjësinë e tij të plotë.

⁷ “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj, pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.